

SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIIN)

Vendosmëria / *el-Azm* /

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës nga nxënësit e hoxhës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Allahu ﷻ tha:

" " "

“Kur të kesh vendosur, mbështetu në Allahun.” (Aal-Imran, 159)

Vendosmëria është realizim i synimit (*kasd*) me a pa dëshirë.¹ Kjo ka tri nivele:

Niveli i parë është rebelimi i gjendjes shpirtërore (*haal*) kundër (kufizimeve të) dijes²:

- Për t'i parë çastet e zbulimit³
- Për t'u kënaqur me dritën e intimitetit ngushëllues (*uns*) pambarimisht⁴

¹ Kur ushtria muslimane u përplas me romakët dhe aleatët e tyre në Mu'tah, Abdullah ibn Rawaaha motivoi vetveten për luftim me këto vargje poetike:

“Të betohem, o *nefs*! O do të hysh, o do të fus me zor!
Njerëzit janë tubuar, kushtrimi është hedhur.
Çfarë ke që s'e do xhenetin!”

² Kjo nuk nënkupton injorim të shariatit a të teksteve fetare. Shejhu (el-Harawi) po na këshillon që të aspirojmë përtej kërkesave të dijes e jo t'i ndjekim pamenduar lehtësimet e shkurtesat ose të ngelim vetëm në zbatimin teknik të thatë (të pashpirt) të dijes a në vetëbesimin e tepruar për dijen që kemi. Ka dhe raste kur dija mund të mos mjaftojë për udhëzimin e dikujt lidhur me ndonjë incident të caktuar. Pikërisht ky është rasti kur personi mund të llogarisë në frymëzim (*ilham*) dhe intuitë (*dhewk*) – siç përmend Imam Ibn Tejmije – për të gjetur udhëzimin. Kjo nuk thuhet në kuptimin që frymëzimi dhe intuita t'i kundërvihen dijes, por në kuptimin që këto ta plotësojnë dijen.

³ Kur Ai ta zbulon shtegun drejt shkallëve (stacioneve) të ndryshme, për të metat e *nefsit* tënd dhe, çka është më e rëndësishme, për kuptimet e emrave dhe cilësive të Tij.

- Për t'iu rrekur asgjësimi të pasioneve (*hawa*)

Niveli i dytë:

- Preokupimi me shijimin e të parit të Allahut (*mushaahade*)⁵
- Ndriçimi i shtegut⁶
- Angazhimi i të gjitha forcave të ndershmërisë⁷

Niveli i tretë:

- Njohja e të metave të vendosmërisë (*azm*)⁸
- Pastaj marrja e vendimit për ta hequr qafesh vendosmërinë⁹
- Pastaj heqja qafesh e pasojave të heqjes dorë nga vendosmëria¹⁰

⁴ Sepse vetëm zbatimi teknik i dijes nuk do të ta sjellë intimitetin ngushëllues në praninë e Zotit tënd. Ti mund të punosh si një rob, por miqtë e Tij janë ata, që mirëprehen në praninë e Tij. Kjo është gjendja e atyre (që ngelin në zbatimin teknik) që kanë zemra të ngurta dhe të thata. Veprat e tyre nuk kryejnë funksionin e as s'i shërbejnë qëllimit. Lutjet e tyre nuk mbrojnë nga paturpësia dhe e keqja. Ata lënë ushqimin dhe pijen, kur agjërojnë, por zemrat e tyre nuk lënë arrogancën dhe mllëfin.

⁵ Që të ndalon t'i shohësh të gjithë të tjerët (*es-siwa*).

⁶ Kur ti i afrosh vendmbërritjes dhe dritat e qytetit ndriçojnë shtegun për tek ai, ti e sheh qartazi, kurse deri aty ke qenë i varur nga shenjat në rrugë.

⁷ Tash ti sheh cakun (portat e qytetit) dhe mbledh tërë energjinë përbrenda për të ngarendur drejt fundit.

⁸ Që t'i atribuosh vetvetes vendosmëri.

⁹ Duke i mohuar vetvetes tiparin e vendosmërisë dhe duke parë atë si një dhuratë nga Allahu.

¹⁰ Të vazhdosh të shohësh lënien tënde të vendosmërisë do të thotë se ti ende mendon se, në një pikë, ti vërtet ke qenë i vendosur vetvetiu (dhe s'e ke pasur dhuratë nga Allahu).